

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“1Net” Sh.P.K.

Në Sarandë sot më datë 20.07.2023, në respektim të kërkesave të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me vullnetin tonë të lirë në të nënshkruarit :

➤ **Skerdilajd MUHO**, i biri i Kastriot-it, lindur më 17.08.1982 në Sarandë, dhe banues në Lagjja 2, Rruga “Onhezmi”, Sarandë, mbajtës i leternjoftimit No.035750394 dhe numer personal I20817102D me datë lëshimi 04.02.2020 Shpall themelimin e shoqërise me përgjegjesi te kufizuar, si me poshtë vijon:

Neni 1

Shoqëria quhet “1Net” shpk (shoqëri me përgjegjesi te kufizuar)

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia zyrtare e Shoqërise ndodhet ne adresen Lagjja 3, Studenti, Godine 2-kateshe, Sarandë. Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqërise mund te transferohet ne nje rajon tjetër brenda territorit te Republikës se Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë apo dhe jashte tij.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

- ❖ Shërbime akses në internet
- ❖ Shërbime akses TV
- ❖ Kabllor TV

Shoqëria mund te ushtroje cdo veprimtari tjetër tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtojë ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 1.000 leke (njemije), dhe perbehet nga nje kuote, e ndare si me poshte:

1. Skerdilajd MUHO, kontribuon me 1 (nje) kuote prej 1.000 leke, ose 100% te kapitalit themeltar
Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe shlyer plotesisht.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ne te ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetëm me vendim unanimit te Asamblesë se Ortakeve , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakeve të ri. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te gjithë ortakeve.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e veçanta qe parashikohen nga Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Neni 9

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe përmban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne datën e regjistrimit ne Qenden Kombetare te Regjistrimit.

Neni 10

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund t'a tërheqin. Kjo mund te behet vetëm pasi te nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 11

Kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre ne kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofroje te treteve. Anëtarët e shoqërisë kane përparësi për blerjen e kuotave përpara personave te trete jashtë shoqërisë. Ortaku qe dëshiron te transferoje ose te shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshëm dhe te jete i njëjte me atë qe do t'i ofrohet dhe një personi te trete jashtë shoqërisë si dhe te dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjerë ketë kërkesë dhe ortaket e tjerë duhet te japin nje përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është ne proporcion me kuotat qe zotëron secili prej ortakeve ne këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjerë per te blere te gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave te trete jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimet e kuotave kane efekt mbi shoqërinë qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve dhe ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Kuotat prej 1.000 leke janë te pandashme. Ne rastet e bashkëpronësisë vepohet sipas ligjeve.

Neni 12

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te përmendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen te tetëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi te zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 13

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaku i shoqërisë drejton procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

1- Asambleja e Ortakeve të shoqërisë.

2- Administratori.

Neni 14

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo nga ortaket e përcaktuar sipas nenit 84 të ligjit 9901. Anëtarët duhet të njoftohen jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar dhe në lajmërim duhet të jete shkruar vendi, ora dhe çështjet që do të trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Neni 15

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e mëposhtme:

- Ka të drejtë të beje ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortaket që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka të drejtë të miratoje bilancin e shoqërisë dhe të beje ndarjen e fitimit.
- Ajo emëron administratoret, zëvendësin, ekspertet dhe revizoret kontabël.
- Ajo ka të drejtë të beje përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara në ligj si dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratoret, ekspertet, revizoret kontabël.
- Ben transferimin e kuotave të të tretet.
- Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të beje modifikimin e kontratës së shoqërisë.

Neni 16

- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 17

Kur pjesëmarrja ne asamble është normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontratës se themelimit, Statutit e te ligjeve janë te detyrueshme per te gjithë, edhe per ata qe nuk kane diskutuar edhe për ata qe nuk janë dakord.

Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër qe nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund te përfaqësoje me shume se një ortak.

Ne Asambleshë e Ortakeve marrin pjesë nese është e nevojshme për te dhene mendim pa te drejte vote eksperte, revizore etj.

Neni 18

Asambleja merr vendime te vlefshme ne rastet e parashikuara me poshtë:

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

b) Për ndryshimet ne Statut, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e Pergjithshme Shoqerise merr vendime te vlefshme me tri te katertat e votave te orakeve pjesmarres, siç percaktohet ne piken 1, te nenit 86 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare".

Neni 19

Marrja e vendimeve te Asambleshë, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bëjnë me te duhet te bëhen sipas legjislacionit ne fuqi për ketë qellim.

Neni 20

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qëndrojnë ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin qe i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi eshte dhënë mendimi per kete dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori/et kane te drejte qe te gjitha kompetencat e përmendura me sipër t'i ushtrojnë se bashku apo vec e vec duke qene pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Ata nuk mund te marrin vendime te rëndësishme siç janë huate, te shesin pronat e shoqërisë, apo te bëhen dorëzanes ne emer te saj. Ata nuk mund te kryejne veprime te cilat i lihen ne kompetence Asambleshë se Ortakeve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shpërblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyrës përveç pagimit te shpenzimeve.

Administrator i shoqërise do të jete **z.Skerdilajd MUHO**

Neni 21

Administratori mund të emërojë një ose me shume administratore të deleguar ose përfaqësues të thjeshte për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor të tij. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 22

Administratoret kanë liri të plote për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejnë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Ortakeve.

Neni 23

Administratoret kanë të drejtë të nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata të ndryshme, për furnizime publike private, të ndërmarrin veprime gjyqësore për dhe në emër të shoqërisë, etj. Administratori mund të japin prokurë në kufijtë që i lejon Asambleja e Ortakeve për kategori të caktuara veprimesh.

Administratoret janë të detyruar të mbajnë regjistrat e magazinimit të cilat vihen në dispozicion të organeve kompetente për të mundësuar kryerjen e kontroleve prej saj. Administratoret e shoqërisë janë të detyruar të mbajnë inventar të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratoret.

Neni 24

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 25

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të behet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 26

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

Neni 27

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet

si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 28

Ne rast se kapitali i shoqërisë per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes se shoqërisë.

Neni 29

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron nje ose me teper likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Neni 30

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur ne këtë statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqërisë. Çdo ndryshim behet ne te njëjtën mënyre siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie. Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqërisë ne Sarande, sot me **20.07.2023**.

ORTAKET E SHOQËRISË “1Net” SH.P.K.

Skerdilajd MUHO _____

